

## **BAJRAM LAMAJ**



Drejtor, Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrolli i Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Lindur në 1964. Diplomuar në Ekonomi(1988), dega Financë dhe në Jurisprudencë(2006).

30 vite eksperience pune. 18 vite si auditues në KLSH. Drejtor Departamenti Auditimi nga muaji

gusht 2013. Fusha e ekspertizes: Auditimi i financave publike.

## **INTERESI PUBLIK DHE PRODUKTI I KLSH<sup>iii</sup>**

*nga Bajram Lamaj*

Në aktivitetin e përditshëm të publikut çdo lajm apo informacion që del nga institucionet e ndryshme, nëpërmjet mjeteve të informimit publik si ajo e shkruar dhe audiovizive, veçanërisht informacionet që publikohen në faqet zyrtare të institucioneve, duhet të jenë gjithmonë të përditësuara me tregues që paraqesin interes për publikun dhe grupet e interesit, pra është shumë e rëndësishme përsosja e mënyrës së komunikimit në paraqitjen e rezultateve të punës së një institucioni, konkretisht prezantimi i produktit që jepet për publikun.

Informimi i vazhdueshëm i publikut për aktivitetin që kryen një institucion i lartë shtetëror dhe vënia në dispozicion të publikut dhe institucioneve apo organizatave joqeveritare të produktit që krijohet nga puna që kryen institucioni e bën atë më të hapur dhe transparent ndaj grupeve të interesuara dhe vetë taksapaguesve të një vendi demokratik. Çdo institucion rrit performancën e tij, duke u mbështetur në reformat që kryen për përsosjen e metodologjisë së drejtimit dhe organizimit, dhe qasjen e tij drejt zhvillimit

bashkëkohor në përputhje me kërkesat e nevojës që kemi për përgatitjen për integrimin në Bashkimin Europian.

Në këtë shkrim do të pasqyrojmë produktin që nxjerr për publikun KLSH, sa vlerësohet dhe si mund të përdoret ai, cila është vlera e tij sot, veçanërisht për taksapaguesit shqiptarë të cilët duhet të dinë se si janë përdorur fondet publike si në rrafshin kombëtar dhe atë vendor. Është për tu vlerësuar fakti se dhe në vëndin tonë, ka filluar të ndjehet ndryshimi i reformimit që po kryhet në KLSH këto dy vitet e fundit, pasi ky institucion është tashmë i hapur dhe cilido mund të informohet apo të shkarkojë materiale nga faqja zyrtare për çdo auditim të kryer dhe të njihet me rezultatet e tij. Para disa ditëve ndoqa me shumë interesim emisionin televiziv “ Ajzberg” të gazetarit të njohur Artur Çani në një TV, ku objekti që trajtohej ishte shkëputur nga Raporti vjetor i KLSH për vitin 2012, konkretisht për pagesat që kryhen nga administrata shtetërore, ku për një vend pune paguhen dy persona *, (nuk po trajtojmë shifra pasi ishin objekt i veçantë i atij emisioni)*, ku evidentohet dëmi ekonomik që ishte krijuar shtetit nga kjo shkelje ligjore e drejtueve të institucioneve të ndrushme qëndrore e lokale. U ndjeva mirë, që për ta trajtuar juridikisht këtë problem, ishte i ftuar një specialist i njohur i jurisprudencës në vëndin tonë. Vetë fakti që treguesit e nxjerrë nga KLSH dhe produkti që i është ofruar publikut ( me shifra ) për këto shkelje të diskutuara në panel, u vlerësuan maksimalisht nga pjesmarrësit, tregon se produkti i KLSH ka qenë cilësor dhe me vlerë.

KLSH në aktivitetin e saj udhëhiqet nga Kushtetuta, ligji dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare të INTOSAI, EUROSAI, ku ka aderuar si dhe përvojën që po fitohet nga zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-t Poloni, Slloveni, Turqi, Auditorin e Përgjithshëm i Kosovës, etj. Shtrohet pyetja se; çfarë produkti nxjerr KLSH dhe si mund ta përdorim atë?

KLSH nxjerr një Raport Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet përkatëse për çdo auditim të kryer në institucione qendrore e vendore dhe të gjithë përdoruesit e tjerë të fondeve publike. Për të gjitha auditimet e kryera botohen veçmas në faqen e internetit të KLSH, raportet dhe vendimet e marra nga Kryetari i KLSH, të cilat ju janë dërguar subjekteve të audituara, duke patur gjithmonë në vëmendje ruajtjen e të dhënave personale për persona të ndryshëm që përmenden në material. Në këtë mënyrë, publiku informohet vazhdimisht për punën e KLSH. Gjithashtu në raportet e e tij ofrojmë rekomandime për përdoruesit e fondeve publike, me qëllim rritjen e përmirësimeve në operacionet financiare dhe zbatimin e rregullshëmrisë e ligjshmërisë në aktivitetin e tij. Në se gjatë auditimit, janë evidentuar shkelje apo parregullsi, KLSH rekomandon masa administrative,shpërblim dëmi dhe disiplinore, madje për shkelje që kanë elementë të veprës penale kryejmë kallzim penal.Por a është ky qëllimi i vetëm i KLSH, sigurisht që jo.

Objektivi i KLSH, i caktuar dhe në ligjin organik të tij është auditimi i përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e mirë administrimit financiar, si dhe auditimin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomiko financiare.

Siç shihet fusha e gjërë e problemeve që prek KLSH në auditimet që kryen dhe rezultatet e nxjerra, mendojmë se i vlejné çdo taksapaguesi, institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare, organizmave të tjera ndërkombëtare, pasi raportet e auditimit dhe produkti i nxjerrë ashtu si në çdo vend dhe në vendin tonë, duhet të vlerësohen me rëndësinë dhe vlerën që ka, si një produkt i një organi suprem të auditimit, duke i marrë këto materiale për ti përdorur e servirur ato publikut në një mënyrë sa më të thjeshtë e të kuptueshme. Kjo shtron si nevojë që dhe mediat e tjera, veçanërisht ato vizive, duhet të shkëpusin problematika nga materialet e KLSH dhe të kthehen në debat publik, por do jetë shumë më e efektshme që

në këto debate të jenë të ftuar dhe specialistë të KLSH, sipas fushave përkatëse të audituara, kjo do të sillte një qasje shumë të pranueshme nga publiku.

Përveç institucioneve, që i detyron ligji që materialet e KLSH ti përdorin në të mirë të përmirësimit të menaxhimit të aktivitetit të tyre, duhet të vlerësohen dhe si matës të besueshëm të shkallës së korrupsionit në vend, kjo si një produkt i sjellë me paanshmëri si profesionale por dhe politike. Shtrohet pyetja: A duhet të bëhen objekt diskutimi treguesit që merren nga KLSH-it?, sigurisht që po, arsye kjo që me performancën gjithnjë në rritje që po tregon ky institucion i pavarur kushtetues, natyrisht po sjell risi dhe rritjen e interesit të publikut e besueshmërisë së funksionimit si një institucion efikas në luftën kundër korrupsionit.

Në aktivitetin e tij KLSH, auditon administrimin e pronave, aktivitetin e legalizimeve të ndërtimeve informale dhe aktivitetin e pushtetit vendor. Për ti bërë më të kuptueshme larg shprehjeve teorike, po i analizojmë veçmas se cili është produkti që sjellim për publikun nga këto auditime dhe publikimi i tyre.

Së pari, në problematikën e madhe që është sot në vendin tonë, në lidhje me administrimin e pronës nga institucionet qendrore dhe lokale, mendojmë se çdo taksa pagues ka çfarë të gjejë në materialet e KLSH, pasi aty do të mësojnë se cili është aktiviteti i AKKP, sa janë respektuar aktet ligjore e nënligjore nga administrata e këtyre institucioneve dhe cilat janë rekomandimet që ka dërguar KLSH për përmirësimin e punës, a zbatohen rekomandimet e KLSH, etj.. Po kështu do të mësojnë dhe mbi problemet që ka ngritur KLSH në auditimet e ZVRPP-ve si Qendrore dhe ato të rretheve, aty mund të mësohen dhe abuzimet që janë kryer, pra ka një transparencë të qartë në punën që kryhet.

Publiku mëson nga raportet e auditimit të ALUIZNIT, si po ecën legalizimi, cilat janë shkeljet ligjore, a janë cënuar ata direkt apo indirekt, si janë administruar parat e tyre, ku kanë shkuar ato, etj. Vetem nga hapja e KLSH, në këtë institucion trajtohen shumë ankesa që paraqesin qytetarët për probleme të ndryshme me pronat, ZVRPP dhe legalizimet .Nga ky institucion duke respektuar tagrin ligjor, ju janë dhënë zgjidhje koherente shumë problemeve të tyre, ku institucionet nuk lëviznin, por ndërhyrjet tona sipas tagrave ligjorë, ka sjellë inicimin e shumë veprimeve si për vënien në lëvizje të administratës, por dhe ndalimin e shumë veprimeve të parregullta që mund të kryheshin, pra kemi ndihmuar me rekomandimet tona.

KLSH, auditon pushtetin vendor për aktivitetin ekonomik financiar për rregullshmërinë dhe ligjmërinë e tyre, duke rekomanduar masa për përmirësimin e tyre. Për vetë faktin se shërbimet e pushtetit vendor, janë më afër taksapaguesve dhe më të ndjeshme për publikun, produkti që nxirret për të ja ofruar publikut është shumë i vlefshëm. Kjo diktohet se; së pari, ato duan të mësojnë se si janë përdorur taksat lokale , sa të efektshme ishin ato në përmirësimin e jetës së tyre në komunitet, ato u investuan në drejtimin e duhur apo u shpërdoruan, kush janë përgjegjësit e këtyre shpërdorimeve dhe çfarë është më e rëndësishme, që nesër do të dijë dhe të jetë më i qartë se kujt do tja besojë administrimin e jetës së tyre në komunitet, pra në zgjedhjet lokale, komuniteti ka dijeni për të mirat dhe mangësitë e drejtuesve të komunës, bashkisë, qarkut dhe ato do të jenë më të përgjegjshëm për menaxhimin e jetës së tyre në komunitet, etj.

Në shumë bashki e komuna, nga informacioni që kemi ne si KLSH, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet në shumë raste, nuk prezantohen në këshillat e tyre, nuk bëhen prezent nga ato vetë problemet e ngritura nga auditimi, por veprohet gabim duke i mbajtur ato të mbyllura me qëllimin se : *“prishin performancën(emrin) e Kryetarit dhe institucionit”*. Këto jo vetëm

nuk informojnë njerëzit e duhur siç janë të zgjedhurit, pra këshillat bashkiak e komunal, të cilët medoemos këtë material duhet ta kthejnë në debate publike, për të nxjerrur detyra për të ardhmen, që tu shërbehet sa më mirë komunitetit të tyre.

Njohja me rezultatet e auditimit, pra marrja e produktit të një auditimi nga komuniteti, (publiku) do të sillte një qasje akoma më të mirë të punës së KLSH, në drejtim të përgjegjësisimit dhe ndikimit në përmirësimin e punës menaxheriale të drejtuesve vendorë në të mira për taksapaguesit e tyre. Vetë këshillat lokalë nuk duhet të mjaftohen me informimin e njoftimit nga media vizive apo e shkruar të nxjerrë nga KLSH, por ato përveç faqes së internetit duhet ti drejtohen dhe direkt KLSH për marrjen e një informacioni më të plotë, e drejtë kjo për informim publik sipas Kushtetutës së RSH. Për këtë hapat e parë nga KLSH janë hedhur, ku siç po shihet kemi një transparencë më të dukshme dhe komunikim publik mjaft të efektshëm dhe frytdhënës. Pra KLSH ka dalë nga ajo ndërtesë e mbyllur, ku ishte para dy vitesh, tani kemi një staf më të konsoliduar profesionalisht dhe marrëdhënien me publikun e sheh si një mundësi e përmbushjes së detyrës tij si një organ i pavarur kushtetues. Vetëm për periudhën 2012- 3 mujorit I të vitit 2013, KLSH ka botuar një sërë botimesh, ku veçohen raportet vjetore 2011,2012, Revista shkencore periodike 4 mujore “Auditimi publik” tre volume, shkrime të ndryshme në median e shkruar, etj.

Duhet të thyejmë mentalitetin e krijuar se KLSH është një institucion, që kryen një detyrë si institucionet e tjera , raporton në Parlament dhe përmbush “thjesht” një detyrë, Jo, ka ardhë koha që vetë publiku duhet të kërkojë e marrë një produkt sa më të mirë nga ky institucion i pavaruar , ku me aktivitetin që po kryhet , po tregojmë se në shqipëri mund të kryesh funksionet shumë mirë dhe si institucion i pavarur, larg politikës e kapjes nga korrupsioni. Për këtë është taksapaguesi shqiptar, që ka interes të

mësojë se si përdoren parat publike në vendin tonë. Çdo qytetar po të kërkojë në faqen e internetit të KLSH, kemi besim se do të gjejë atë që deri para pak kohësh nuk kishte asnjë mundësi, të qënit institucion transparent do na bëjë më të pranushëm nga publiku dhe do kemi qasje pozitive në produktin që do ofrojmë për publikun, brenda hapësirës së përcaktuar nga ligji në veprimtarinë tonë të përditëshme, në përmbushje të misionit të caktuar .

---

<sup>i</sup> Botuar në Gazetën “Telegraf” dt. 25 Qershor 2013

<sup>ii</sup> Shkrime të tjera të autorit (të papërfshira në këtë botim) gjatë vitit 2013:

- Produkti i KLSH përballë interesit publik (Shqiptarja.com, 23 qershor 2013)
- Produkti i KLSH përballë interesit publik (Shqip, 03 korrik 2013)
- Menaxhimi financiar, kontrolli i brendshëm dhe qeverisja e mire (Tirana Observer 06 gusht 2013)